

Njoftim për përqendrim me të cilin Norstat AS, Oslo, Norvegji do të fitojë kontroll mbi Shoqërinë për Tregti dhe Shërbime DATA SOLUTIONS GROUP SHPK Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Sample Solutions B.V., Rotterdam, Holandë (lënda nr. 08-83/2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 05.05.2025, në Komisionin për mbrojtjen e konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin Norstat AS me seli të regjistruar në adresën Fritjof Nansens plass 5, 0160 Oslo, 0301 Oslo, Norvegji, synon të fitojë kontroll të vetëm indirekt mbi Shoqërinë për Tregti dhe Shërbime DATA SOLUTIONS GROUP SHPK Shkup me seli të regjistruar në Leninova nr. 21/18, Shkup-Qendër, Republika e Maqedonisë së Veriut, dhe Sample Solutions B.V. me seli të regjistruar në Halfroond 41, 3071PP Rotterdam, Holandë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

Norstat AS me seli të regjistruar në adresën Fritjof Nansens plass 5, 0160 Oslo, 0301 Oslo, është lider evropian në mbledhjen e të dhënave për hulumtimet e tregut.

Shoqëria është themeluar në Norvegji në vitin 1997 dhe ka zgjeruar praninë e saj gjeografike duke përfshirë Danimarkën, Suedinë, Finlandën, Estonin, Letoninë, Lituaninë, Poloninë, Gjermaninë, Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën, Francën, Zvicrën, Holandën, Austrinë dhe Italinë.

Norstat AS siguron të dhëna me cilësi të lartë përmes metodave të ndryshme të mbledhjes së të dhënave, duke u mundësuar klientëve të marrin të dhëna të besueshme për temat e dëshiruara të hulumtimit dhe grupet e synuara.

Norstat AS as nuk është i pranishëm dhe as nuk gjeneron të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

Shoqëria për Tregti dhe Shërbime DATA SOLUTIONS GROUP SHPK Shkup me seli të regjistruar në rrugën Leninova nr. 21/18, Shkup-Qendër, Republika e Maqedonisë së Veriut, me veprimtari kryesore 63.11 – Përpunimi i të dhënave, hostimi dhe veprimtari të ngjashme.

Shoqëria për Tregti dhe Shërbime DATA SOLUTIONS GROUP SHPK Shkup nuk ofron shërbime dhe nuk gjeneron të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

Sample Solutions B.V. është shoqëri holandeze me seli të regjistruar në rrugën Halfroond 41, 3071PP Rotterdam, Holandë.

Sample Solutions B.V. është furnizues i të dhënave dhe teknologjisë i fokusuar në shërbime për marrje mostrash globale dhe mbledhje të të dhënave për hulumtime të tregut.

Sample Solutions B.V. ndihmon organizatat me realizimin e anketave (p.sh., me telefon, online, në adresë), pasurimin e të dhënave dhe analizën, duke u mundësuar studiuesve dhe marketingut të arrijnë saktësisht dhe në mënyrë efikase audiencën e tyre të synuar.

Sample Solutions B.V. nuk është i pranishëm, nuk ofron shërbime dhe nuk gjeneron të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. „Shën Kirili dhe Metodi” nr.54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

15.05.2025

Shkup